

DREJTORIA PËR BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL DHE ORGANIZATA "QATAR CHARITY"

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Organizata "Qatar Charity" në kuadër të marrëveshjes së arriturë me nr. 02-320/01-0074859/22 të datës 30.08.2022 në komunën e Podujevës, shpallë këtë:

F T E S Ë P U B L I K E

(Për mbështetjen e familjeve në nevojë)

Për aplikim në projektin:

- *Motokultivator me frezë dhe kosë (pa rimorkio*
- *Motokultivator me frezë dhe kosë (me rimorkio)*

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriterët si:

- Të jetë banorë i Komunës së Podujevës;
- Të ketë mundësi për ta realizuar projektin;
- Të ketë përshtatshmëri të vendit për realizimin e projektit;

Në kushte të barabarta përparësi do të kenë:

- Familjet të cilët nuk kanë përfutur më parë;
- Familjet me numër më të madh të antarëve;
- Familjet me asistencë sociale;
- Familjet me fëmijë jetim;
- Familjet me anëtarë që vuajnë nga sëmundje të rënda kronike apo invaliditet;
- Banorët e Komunës së Podujevës të cilët jetojnë në zona të thella rurale;

Dokumentet obligative për aplikim:

- Kërkesën e plotësuar për aplikim;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën nga Gjykata Themelore në Podujevë, që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime;
- Çertifikatën e Bashkësisë Familjare (*kërkesat vërtetohen*);
- Konfirmimin e të ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë);

Dokumentet shtesë për aplikim:

- Dokumente zyrtare kopje (*familjet me anëtarë që kanë sëmundje të rënda kronike apo ato me invaliditet*);
- Kartelën e ndihmës sociale kopje (*familjet me asistencë sociale*);

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve, nga data 05.09.2022 deri me datë 16.09.2022, ora 8:00-16:00.

Vëmendje: Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në një kopje dhe brenda periudhës së aplikimit, pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Nr:
Podujevë
05.09.2022



Drejtori për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
z. Fatmir Rudari